



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:072369

Datë: 27.03.2019

Numri i dokumentit: 00259080

P.nr.11/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues A. Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit A. GJ. ..., i akuzuar për vepër penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, me PP/II.nr.2686/18, dt.15.01.2019, në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të mbajtur me dt. **26.03.2019**, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Lumturije Hoxha të pandehurit A. GJ. si dhe mbrojtësit të tij Av. Blerim Ademaj nga Peja, Gjykata të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me dt.27.03.2019, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **A. GJ.**, i lindur me Istog, biri i B. dhe nënës Z. gjinisë Q., i martuar, baba i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore ,bujk, me numër personal:....., i gjendjes dobët ekonomiko-familjare, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë nga ana e Gjykatës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më dt. 08.12.2018 rreth orës 02:55 në Istog në rrugën “...”, në automjetin e tij Golf me targa ... në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për armë (Ligji Nr..... , ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armë zjarri, në atë mënyrë që natën kritike pas kontrollit dhe bastisjes që i është bërë të njëjtit, nga ana e policisë atij, i është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë 7.65mm, një karikator me katër fishekë të kalibrit 7.65mm dhe një karikator me tetë fishek të kalibrit 7.65mm,

- me çka ka kryer vepër penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42 , 43 , 46, 62, 69, 73, 74 dhe neni 374 par. 1 të KPRK, si dhe neni 233,359, 360, 361, 365, 366, 450 të KPPRK, të pandehurit i shqipton.

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që:

1.Të pandehurit **A. GJ.**, Gjykata i përcakton dënim me gjobë në shumën prej **400(katërqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afatin prej **30 (tridhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2.Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e lartë shqiptuar sipas afatit, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës.

3.I I pandehuri lirohet në tërësi nga shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor, për faktin se i takon gjendjes së dobët ekonomike-familjare dhe është shfrytëzues i ndihmës sociale.

DËNIM PLOTËSUES

4.Konform nenit 62 par.2 nen par.2.7 dhe nenit 69 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues marrja e sendit, ku i konfiskohet, një pistoletë 7.65mm, një karikator me 4 fishek të kalibrit 7.65mm, dhe një karikator me 8 fishek të kalibrit 7.65mm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Përgjithshme, pranë kësaj Gjykate ka ngrit aktakuzën me PP/II.nr.2686/2018, dt.15.01.2019, ndaj të pandehurit A. GJ. nga f.sh. ..., duke e akuzuar për vepër penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, njeherit së bashku me aktakuzë, në gjykatë e ka dorëzuar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë të lidhur në prokurori me dt.14.01.2019, në mes të Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit te tij i caktuar sipas detyrës zyrtare, me propozim që i akuzuari të dënohet me dënim me gjobë si dhe me propozim që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi plotësues i konfiskimit të armës dhe dy karikatorëve me municion.

Gjykata me datën 26.03.2019, mbajti seancën për shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në praninë e Prokurorit të Shtetit, Lumturije Hoxha, të pandehurit A. GJ. si dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av. Blerim Ademaj nga Peja.

Gjykata në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë e ka vlerësuar së marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur konform nenit 233 të KPPRK-së dhe pasi që është bindur që e njëjta është e bazuar në ligj të njëjtën me aktvendim në procesverbal e ka aprovuar.

Meqenëse gjykata e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, para së të kalojë në vendimin mbi dënim i ka ftuar palët që të deklarohen lidhur me dënimin.

Prokuroi i Shtetit Lumturije Hoxha ka deklaruar se qëndroj pranë përmbajtjes se marrëveshjes te arritur ne prokurori me dt.14.01.2019, e cila marrëveshja është përpiluar komfor dispozitave ligjor nga neni 233 te KPPK-së dhe e njëjta po ashtu është arritur ne prezencën e mbrojtësit dhe te pandehurit, andaj si e tillë kërkoj qe nga ana e gjykatës te aprovohet dhe te njëjtiti ti

shqiptohet dënimi kryesor në kuadër të marrëveshjes dhe po ashtu ti shqiptohet edhe dënimi plotësues i propozuar si në marrëveshje, ndërsa sa i përket lartësisë së dënimit të mbetet në sekrecion të gjykatës që të vendos.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati Blerim Ademaj deklaron: se qëndroj në tërësi pranë marrëveshjes së arritur në prokurori dhe i propozoj gjykatës që klientit tim ti shqiptoj minimumin e dënimit në kuadër të marrëveshjes me pranim fajësie për faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike – sociale, është shfrytëzues i ndihmës sociale me çka e dëshmon edhe me karton të socialit që është pjesë e shkresave të lëndës, dhe kisha kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj minimumi i dënimit të paraparë nga marrëveshja si dhe ta liroj nga shpenzimet procedurale për shkak se është shfrytëzues i ndihmës sociale.

Ë akuzuari A.GJ. deklaron: Se në tërësi pajtohem me marrëveshjen e arritur dhe propozoj që të shqiptohet minimumi i dënimit të paraparë në marrëveshje për faktin se e kam gjendjen shumë të dobët ekonomiko – sociale.

Me faktet e ofruara si dhe duke marrë për bazë arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë është vërtetuar se i pandehuri me dt.08.12.2018 rreth orës 02:55 në Istog në rrugën "...", në automjetin e tij Golf me targa në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për armë (Ligji Nr.05/L-022) , ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armë zjarri, në atë mënyrë që natën kritike pas kontrollit dhe bastisjes që iu ka bërë të njëjtit, nga ana e policisë të pandehurit i është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë 7.65mm, një karikator me katër fishekë të kalibrit 7.65mm dhe një karikator me tetë fishekë të kalibrit 7.65mm,

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A. GJ. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, konform neneve 73, 74 të KPRK-së për të akuzuarin i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, ka vlerësuar faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë ku ka arritë marrëveshje në Prokurori, është përnduar për veprën e kryer, ka treguar sjellje të mira në gjykatë është në moshë relativisht të re dhe jeton në gjendje të dobët ekonomike ku të ardhurat për familjen 10 anëtarësh i siguron nga puna e krahut dhe ndihma sociale.

Rrethanë rënduese gjykata gjeti rrezikshmërinë që paraqet kjo veprë penale, si dhe denushmërinë e saj, si dhe faktin se i pandehuri ishte edhe më parë i dënuar sipas aktgjykimit të gjykatës me P.nr.179/18 të dt. 12.11.2018, për veprë penale nga neni 378 par.8 lidhur me parë 6 të KPRK-së, është dënuar me dënim me kusht.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale ne të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPRK-së.

Gjykata konform nenit 62 par. 1, par. 2 nënpar. 2.7 dhe nenit 69 të KPRK-së të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin plotësues të përshkuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 453 të KPRK-së, Gjykata e ka liruar të pandehurin në tërësi nga shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor, për faktin se është i gjendjes së dobët ekonomike. dhe shfrytëzues i ndihmës sociale, sipas kartonit të socialit me nr.regj.14747, Andaj çdo ngarkesë materiale ndaj tij do te ishte shumë e rend për të dhe familje e tij.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM
P.nr.11/19 datë 26.03.2019

Sekretarja Juridike

Hale Ahmetaj

Gjyqtari

Gjykues

A. Mustafaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës se Apelit ne Prishtine e përmes kësaj Gjykate.